




Republika e Kosovës



**TIKA**



Komuna e Vushtrrisë

**Drejtoria për Bujqësi, dhe Zhvillim Rural dhe Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TIKA)**

09.nr. 10/2024

|                        |   |
|------------------------|---|
| DATË/A:                | 15.04.2024  |
| PËR/ZA/TO:             | Të gjithë të interesuarit për aplikim për Moto kultivatorë me frezë |
| NGA/OD/FROM:           | Drejtoria për Bujqësi, dhe Zhvillim Rural<br>z. Ergin Sunguri       |
| PËRMES:                | z. Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës                                  |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | <b>Thirrje për Aplikim</b>  |

Duke u bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit në kuadër të projektit “Mbështetja e Fermerëve me Mekanizëm Bujqësorë në Komunën e Vushtrrisë” me numër 242/24 të nënshkruar me datën 14.03.2024 në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Agjencisë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TIKA), Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, shpallë këtë:

**FTESË PUBLIKE  
PËR APLIKIM NË PROJEKTIN:  
MBËSHTETJA E FERMERËVE ME MEKANIZËM BUJQËSORË NË KOMUNËN E  
VUSHTRRISË**

**70 fermer përfitues**

*Lloji i përkrahjes: Motokultivatorë me frezë*

**Dokumentet e nevojshme për aplikim:**

1. Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës
2. Certifikata e bashkësisë familjare
3. Certifikata e regjistrimit të fermerit (NIF-i)



**Përparësitë për aplikim:**

---

1. Familjet (aplikuesit) pa asnjë anëtar të punësuar (deklarata e papunësisë për personat mbi moshën 18 vjeçare )
2. Aplikuesit të cilët nuk kanë përfituar ndonjë projekt nga Komuna apo donatorët në bashkëpunim me Komunën në 3 vitet e fundit
3. Familjet me numër më të madh të anëtarëve
4. Familjet e dëshmorëve, invalidëve të luftës apo grupet e marginalizuara
5. Familjet që mbjellin mbi 0,50 ari serë ose mbi 5 ari në ambient të hapur,

**SQARIM**

*(Projekti do të realizohet në bashkëpunim në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Agjencisë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim)*

Subvencionimi në projektin e cekur realizohet përmes formës së participimit financiar nga ana e fermerëve përfitues.

- ❖ Fermerët përfitues do të marrin pjesë me 15% të vlerës së projektit.
- ❖ Komuna në cilësinë e subvencionuesit do të marrë pjesë me 30% të vlerës së projektit.
- ❖ Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim do të marrë pjesë me 55% të vlerës së projektit.

*Aplikacionet (kërkesat) dorëzohen në Zyrën e Shërbimit të Qytetarëve.*

**Afati i fundit për aplikim do të jetë më datën 26.04.2024, deri në orën 16:00**

**Vushtrri**

**08 Prill 2024**

